

Jane Dimoski nga Shkupi është heroi dhe humanisti ynë i sotëm. Ai është shëruar nga sëmundja COVID-19 dhe u paraqit vullnetarisht të dhuroj plazmë. Ai ishte i padurueshëm në pritje të rezultateve të analizave sipas protokollit për dhurimin e plazmës konvalescente dhe sot dëshira e tij e madhe për të dhuruar u bë realitet. Plazma e tij është një ilaç ndoshta edhe i vetmi për disa pacientë me sëmundje mesatare deri të rëndë të COVID-19. Në të njëjtën kohë, ai shprehu dëshirën për të ndihmuar në stimulimin e të tjerëve që kanë të njëjtën mundësi si ai për të dhuruar plazmë. Ne si Institucion e falënderojmë Jane Dimoskin për angazhimin e tij për të ndihmuar në këto momente të vështira.

